

**Vendim nr. 286 datë 27.11.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 27.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 14 (F) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES:** **FATMIR ALMADHI, SHEJE ALMADHI**, të përfaqësuar nga avokatët Irene Dule dhe Dorian Matlija, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** **Konstatimi i shkeljes së nenit 21 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në aspektin procedural të tij, për shkak të moskryerjes së një hetimi efikas, të plotë dhe të gjithanshëm.**

**Shfuqizimi i vendimeve nr. s'ka, datë 21.07.2017, për pushimin e procedimit penal nr.2773, të vitit 2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 83 akti, datë 09.11.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 150, datë 31.01.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-636, datë 24.04.2023 2017 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

**Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosarsyetimit të vendimit gjyqësor në harmoni me provat dhe parashikimet ligjore.**

**BAZA LIGJORE:**

Nenet 15, 21, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 2 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Në datën 07.11.2012 fëmija i mitur i kërkuesve Fatmir dhe Sheje Almadhi, shtetasi D.A., ka humbur jetën gjatë një ndërhyrjeje kirurgjikale estetike për korrigjimin e një gjendjeje patologjike të lindur (rënia e kapakëve të syve), të bërë nga dy mjekë irlandezë (G.F. dhe K.C.) në mjediset e Spitalit Qendror Universitar “Nënë Tereza”, Tiranë (*QSUT*).

2. Në lidhje me ngjarjen e ndodhur, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*), në datën 06.12.2012, ka regjistruar procedimin penal nr. 5705 gjatë hetimeve, për të cilin, në regjistrin e njoftimit të veprave penale është shënuar: “Mjekim i pakujdesshëm”, me pasojë vdekjen, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 96 dhe 25 të Kodit Penal (*KP*), ndërsa si autorë të saj janë shënuar emrat e dy mjekëve irlandezë. Këta të fundit, në vijim, janë akuzuar për këtë vepër penale dhe janë dërguar për gjykim, në përfundim të të cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1043, datë 03.04.2015, ka vendosur të deklarojë fajtor shtetasin K.C. (mjeku anestezist), të cilin e ka dënuar me gjobë, ndërsa shtetasin G.F. (mjeku kirurg) e ka deklaruar të pafajshëm. Ky vendim më pas është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 194, datë 17.02.2016.

3. Po lidhur me ngjarjen, në vitin 2015, kërkuesit kanë depozituar një kallëzim penal ndaj drejtuesve të QSUT-së, me pretendimin se ata kanë lejuar mjekët irlandezë të kryenin operacionin e djalit të tyre pa pasur licencë dhe pa asnjë dokument sipas legjislacionit shqiptar. Për këtë kallëzim, Prokuroria e Tiranës, me vendimin e datës 16.11.2016, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti penal objekt kallëzimi ishte hetuar dhe gjykuar në kuadër të procedimit penal nr. 5705 të vitit 2012. Mbi ankimin e kërkuesve, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 404, datë 25.04.2016, ka shfuqizuar vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve në lidhje me kallëzimin penal të kërkuesve. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

4. Në zbatim të vendimit të gjykatës, Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr. 2773 të vitit 2017 dhe pasi ka administruar disa prova në funksion të hetimeve paraprake, me vendimin e datës 21.07.2017, bazuar në nenin 328, pika 1, shkronja “b”, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, me arsyetimin se fakti objekt hetimi nuk parashikohet nga ligji si veprë penale, ndërsa nuk përmbante elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” ose të ndonjë veprë tjetër penale, pasi ndryshe nga sa kallëzuesit pretendonin, veprimtaria e mjekëve irlandezë, pjesëtarë të Shoqatës “Miqte Irlandezë të Shqipërisë”, është realizuar në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të datës 23.10.2009, të amenduar në datën 12.04.2010, qëllimi i së cilës ka qenë thellimi i njohurive të mjekëve shqiptarë në fushën e mikrokirurgjisë plastike, përfshirë edhe aspektet e aplikimit kirurgjikal dhe anestezisë së zgjatur, si dhe kryerja e operacioneve nga pala irlandeze, projekt i cili është miratuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë, referuar shkresës së saj nr. 28/10, datë 28.10.2005, për aprovimin e projektit, sikundër edhe shkresës, letrës së falënderimit nr. 15/3, datë 15.03.2006. Po kështu, është arsyetuar se ky fakt ishte hetuar në kuadër të procedimit penal nr. 5705 të vitit 2012, duke mos u gjetur shkelje në lidhje me marrëveshjen dypalëshe.

5. Kërkuesit kanë paraqitur ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal, duke pretenduar se hetimi ka qenë sipërfaqësor, ndërsa kanë shtuar se edhe drejtuesit e QSUT-së kanë neglizhuar totalisht kontrollin për mjekët irlandezë, duke i lënë ata të kryenin operacione pa pasur marrëveshje, pa verifikuar dokumentet e tyre, pa akreditim, pa siguruar mbikëqyrje, pa siguruar sallat e operacionit me preparatet e duhura dhe pa konsultim të rasteve klinike me mjekët e pavijoneve. Ata kanë paraqitur si provë vendimin nr. 2516 (80-2017-2548) datë 06.06.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin është

---

pranuar pjesërisht padia e kërkuësve dhe familjarëve të tjerë, duke u detyruar QSUT-ja t'i dëmshpërblejë ata për dëmin jopasuror të shkaktuar nga vdekja e familjarit të tyre.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 83 akti, datë 09.11.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit penal nr. 2773 të vitit 2017, duke arsyetuar se hetimet ishin të plota dhe se referuar nenit 66, shkronja “ç”, të KP-së, vepra penale “Shpërdorimi i detyrës” është parashkruar, ndërkohë që vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë nuk përbënte provë për shkak se nuk ishte i formës së prerë. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 150, datë 31.01.2018, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se hetimet ishin të plota, të gjithanshme dhe objektive, ndërsa janë verifikuar të gjitha pretendimet e kallëzuesve. Edhe sipas gjykatës së apelit, veprimet ose mosveprimet e drejtuesve të QSUT-së nuk përmbanin elemente të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” ose të ndonjë vepre tjetër penale dhe se veprimtaria e QSUT-së dhe e drejtuesve të saj ishte mbështetur në një aktmarrëveshje bashkëpunimi dypalëshe të miratuar edhe nga Ministria e Shëndetësisë, ndërkohë që midis veprimtarisë së drejtuesve të QSUT-së dhe pasojës së ardhur, në rastin konkret, nuk ekzistonte ndonjë lidhje shkakësore. Kundër këtij vendimi kërkuësit kanë ushtruar rekurs.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2023-636, datë 24.04.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësve, me arsyetimin se ai nuk u përmbahej shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së.

9. Në datën 19.09.2024 kërkuësit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuësve

10. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 10.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial në gjykatë*, pasi përpara Gjykatës së Lartë janë ngritur çështje për zbatimin e gabuar të ligjit procedural dhe mospërmbushjen efektive të kompetencave nga gjykata e apelit, pretendimeve të cilave nuk u është dhënë përgjigje.
- 10.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit ka arsyetim sipërfaqësor, nuk u jep përgjigje pretendimeve të kërkuesve dhe ka nxjerrë përfundime formale, të paarsyetuara dhe të pabazuara në prova, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk i ka korrigjuar këto mangësi.
- 10.2. *Të drejtën e jetës*, të garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në aspektin procedural, për shkak të mungesës së një hetimi të plotë, të gjithanshëm dhe efikas të faktit penal për rastin e humbjes së jetës. Në hetimin e ngjarjes prokuroria dhe, më pas edhe gjykatat, nuk kanë respektuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), ndërsa në rastin konkret nuk është kryer një hetim i plotë dhe efektiv, por ai është mjaftuar vetëm me dërgimin për gjykim të mjekëve irlandezë, por pa nxjerrë përgjegjësitë e drejtuesve të QSUT-së.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesve

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Kolegji vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e prindërve të

viktimës së veprës penale kanë qenë palë në procesin gjyqësor ku është vendosur pushimi i çështjes penale të vënë në lëvizje mbi kallëzimin e tyre, proces për të cilin, sikundër edhe për procesin penal në tërësi, kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, ndaj, për rrjedhojë, provojnë interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar si viktimë jo të drejtpërdrejta të shkeljeve të pretenduara gjatë këtij procesi.

13. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesit i janë drejtuar asaj, duke ngritur pretendime për procesin penal në tërësi që është përmbyllur në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj ata e ka plotësuar edhe këtë kriter.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet ajo datë kur vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, konstatohet se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit është dhënë nga Gjykata e Lartë në datën 24.04.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 19.09.2024, pra pas gati 17 muajve. Në përgjigjen e saj të datës 14.10.2024, Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi i kundërshtuar është publikuar i arsyetuar në faqen e saj zyrtare në datën 12.07.2023, datë nga e cila ka qenë i disponueshëm për palët.

16. Në lidhje me këtë kriter, në ankimin e paraqitur, kërkuesit dhe përfaqësuesit e tyre kanë pretenduar se janë vënë në dijeni të publikimit të vendimit të Gjykatës së Lartë në datën 13.06.2024, kur ajo gjykatë, në përgjigje të kërkesës së tyre, u ka komunikuar përfaqësuesve, nëpërmjet postës elektronike, se vendimi ishte i publikuar në faqen e saj zyrtare. Po sipas tyre, në një rast të mëparshëm, për një çështje tjetër me të njëjtët kërkues, Gjykata e Lartë ua ka komunikuar elektronikisht vendimin përfaqësuesve të tyre, çka u ka krijuar siguri dhe pritshmëri se e njëjta gjë do të ndodhte edhe në këtë rast. Gjithashtu, sipas tyre, aksesimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë ka qenë i pamundur për shkak se ajo ka qenë jashtë shërbimit për një kohë të

panjohur. Për këtë të fundit, në përgjigjen e saj të datës 14.11.2024, Gjykata e Lartë ka informuar se faqja e saj zyrtare, edhe pse në muajin janar 2023 ka pësuar një ndryshim në konfigurimin vizual, nuk ka qenë asnjëherë jashtë funksionit.

17. Nisur nga sa më lart, Kolegji vëren se, referuar dokumentacionit shoqërues të ankimit kushtetues individual, në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk rezulton që kërkuessit dhe përfaqësuesit e tyre të kenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit, ndaj ata nuk mund të pretendojnë për pasjen pritshmëri për njoftimin elektronik të vendimit të arsyetuar të Gjykatës së Lartë përmes të dhënave elektronike të kontaktit të lëna në një çështje tjetër të tyre. Po kështu, ndryshe nga sa ata pretendojnë, nuk rezulton që faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të ketë qenë jashtë funksionit pas publikimit të vendimit të saj të arsyetuar, të cilin kërkuessit kundërshtojnë. Në analizë të këtyre fakteve, Kolegji vëren se, ndërsa kanë qenë ata që kanë vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë, kërkuessit nuk kanë treguar kujdesin e nevojshëm për të aksesuar faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë ose dhe për të kërkuar informacion prej saj, për të marrë kështu dijeni në kohën e duhur për vendimin e arsyetuar të asaj gjykate. Nga ana tjetër, kjo mungesë kujdesi nuk mund të përlligjë paraqitjen nga kërkuessit të ankimit kushtetues individual pas më shumë se 14 muajve nga bërja i disponueshëm për palët të vendimit të Gjykatës së Lartë, pra përmbi 10 muaj në kapërcim të afatit ligjor.

18. Nën dritën e sa më sipër, si dhe duke pasur parasysh standardet e vendosura për momentin e marrjes dijeni të vendimit, i cili përbën mjetin e fundit ankimor, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuessve është paraqitur dukshëm në kapërcim të afatit ligjor 4-mujor, ndaj ata nuk legjitimohen *ratione temporis*.

19. Në kushtet kur një nga kriteret paraprake nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë për shqyrtim të kërkesës bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

20. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

---

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.